

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
 GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
 MINISTRY OF JUSTICE
 Nr. D. No: 08-706/9
 Data/Datumi/Date: 15 / 12 / 2020
 Eshtojca/Dodaci/Annex:
 PRISHTINE/PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
 Departamenti për Profesione të Lira-Departament Slobodnih Profesija- Department of
 Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.17/2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, Diellza Hoxha dhe Mujesere Mujku, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e i dyshuar për shkelje disiplinore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në lëndën P. nr 30/2020, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike me datën 20.11.2020, me shumicë votësh, me datën 11.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-17/2020, datë 02.11.2020, dhe ankesa e palës ankuese, ë datës 15.09.2020 dhe 25.09.2020, si të pa bazuara.
- II. Organi përmbarues-Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P. nr 30/20.

A r s y e t i m

Me datën 15.09.2020, përkatësisht me datën 25.09.2020, pala ankuese, me seli në Prizren, me pronar ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e për shkelje nga nenet 365, 366, 367 par 1, pika 1.1, 1.2, dhe 1.4, të Ligjit të Procedurës Përmbarimore sepse i njëjti ka

tejkualuar autorizimet e tij dhe gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij nuk i është përmbajtur ligjit. Pala ankuese pretendon që përmbaruesi privat në kundërshtim me dispozitat ligjore i kishte dorëzuar në posedim qelësat e lokalit të cilin pala ankuese e kishte marr me qera kreditorit. Poashtu, pala ankuese pretendon që kreditori i kishte dëmtuar plakën-reklamën ku ishte emri i lokalit. Për dëmet e shkaktuara pala ankuese ka ngritur padi ndaj kreditorit për kompenzim dëmi. Shton që vlerësimi i vlerës të sendeve që janë shitur është nën çdo standard minimal të vlerësimit profesional. Sendet janë shitur me çmime nën vlerën tregut. Në fund, pala ankuese pretendon që përmbaruesi privat nuk i kishte dhënë udhëzimet dhe shkresat në gjuhën turke të cilën ai kupton.

Me datën 02.10.2020, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat i organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e , lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën P. nr 30/20.

Përmbaruesi privat në përgjigjen e tij me shkrim deklaroi që të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje janë ndërmarr në pajtim me dispozitat ligjore dhe autorizimet që dalin nga ligji. Shton se përmbarimi është lejuar pasi pala kishte shfrytëzuar të drejtën e saj të ushtrimit të prapësimi. Pala ankuese ka ushtruar ankesa ndaj udhrit P. NR 16.09.2020, dt 16.09.2020, kurse i autorizuari i kreditorit përgjigje në ankesë dhe çështja është në procedurë gjyqësore. Pala ankuese ka ushtruar mjetet juridike atëherë zhvillimi i procedurës disiplinore nuk ka asnjë kuptim. Lidhur me pretendimet për mungesën e përkthimit, përmbaruesi privat thekson që dokumentet janë të përkthyer në gjuhën turke dhe ato i janë dhënë debitorit me kohë. Në ditën e ankantit publik, vjehrra e palës debitore kishte përkthyer siç edhe konstatohet në procesverbal dhe gjithçka ishte e qartë për debitorin.

Me datën 20.11.2020, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore. Znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat duke theksuar se bazuar në ankesën e parashtruar nga pala ankuese, përmbaruesi privat ka bërë shkelje disiplinore me rastin e ndërmarjes së veprimeve përmbarimore në lëndën P.nr 30/20 duke shkelur ligjin dhe tejkualuar autorizimet ligjore.

Pala ankuese si dhe përfaqësuesi sipas autorizimit av. elaboruan ankesën dhe pretendimet ankimore.

Poashtu, edhe përmbaruesi privat ka prezentuar sqarimet përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij duke theksuar se ai ka vepruar në pajtim me ligjin dhe ka kërkuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të

këtij vendimi është vërtetuar në mënyrë drejtë dhe të saktë dhe se përmbaruesi privat nuk ka kryer vepër disiplinore.


Komisioni gjen se përmbaruesi kishte zhvilluar procedurën përmbarimore pasi gjykata kishte vendosur lidhur me prapësimin e paraqitur nga debitori. Përmbaruesi privat nuk ka diskrecion por obligohet të zbatoj procedurën përmbarimore mbi bazën e propozimit të palës kreditore. Këtë kishte bërë përmbaruesi. Është e qartë se pala ankuese konsideron që vlerësimi i sendeve nuk është sipas standardeve profesionale dhe është nën çmimin e tregut. Por vlerësimi nuk mund t'i atribuohet sjelljes së përmbaruesit privat. Vlerësimi është bërë nga eksperti e jo përmbaruesi privat. Pala ankuese konsideron që është dëmtuar nga shitja e sendeve në ankantin publik dhe për këto pretendime ka ngritur padi pranë gjykatës kompetente për kompensim dëmi. Këto pretendime megjithatë nuk mund të ngriten përsëri pranë Komisionit Disiplinor për përmbaruesit privat. Procedurat disiplinore pranë këtij Komisioni nuk janë procedura shtesë të procedurave gjyqësore apo zëvendësuese të tyre ku palët adresojnë pretendimet ligjore për të cilat parimisht vendos gjykata. Thënë ndryshe, procedura pranë Komisionit nuk është procedurë instancionale ku palët ngrisin pretendimet e tyre për çështje juridike të cilat shqyrtohen nga ana e gjykatave në procedura ligjore. Palët kanë të drejtë të shfrytëzojnë mjetet juridike në dispozicion, siç edhe ka bërë pala ankuese, për të adresuar shqetësimet dhe pretendime e saj në procedura gjyqësore. Komisioni nuk është i thirrur t'i vlerësoj apo të jap komentime përkitazi me çështjet të cilat janë në shqyrtim pranë gjykatave. Rrjedhimisht, Komisioni vlerëson se pretendimi i palës ankuese përkitazi me vlerësimin që eksperti i kishte bërë sendeve të cilat ishin shitur në ankantin publik, nuk bie në kompetencë të kësaj procedure.

Sa i përket sjelljes nga ana e përmbaruesit privat, Komisioni nuk gjen asnjë provë e cila në mënyrë të arsyeshme mbështet një pretendim për sjellje në kundërshtim me ligjin. Specifikisht lidhur me dhënien e qelsave palës kreditore, neni 90 i LPP parashihet që *“me propozimin e kreditorit, organi përmbarimor mund të vendos që ato t'i dorëzohen për ruajtje atij”*. Pala ankuese pretendon që kreditori i ka dëmtuar mes tjerash edhe pllakën -reklamën. Komisioni, vlerëson, që çështjen e dëmit, pala e ka adresuar në padinë për kompensim dëmi. Lidhur me këto pretendime, gjykata do të vendos në procedurë gjyqësore. Megjithatë, ky dëm i pretenduar nuk mund t'i atribuohet sjelljes së përmbaruesit privat. Tutje, lidhur me pretendimet që Përmbaruesi privat nuk i kishte ofruar shërbimet palës debitorë në gjuhën të cilën ai kupton, Komisioni gjen se përmbaruesi privat i kishte përkthyer palës debitorë në gjuhën turke dokumentacionin dhe i kishte ofruar palës ankuese informacionin dhe gjitha shkresat e lëndës. Pala ankuese kishte parashtruar ankesë tek përmbaruesi privat me dt 04.09.2020 duke kërkuar mes tjerash anulimin e ankantit derisa të vendos gjykata, por nuk kishte parashtruar asnjëherë vërejtje lidhur me përkthimin. Madje edhe ditën kur ishte organizuar ankanti publik, pala ankuese nuk kishte ngritur shqetësime lidhur me përkthimin. Askund në shkresat e lëndës nuk ka vërejtje lidhur me përkthimin. Ky pretendim është ngritur vetëm pasi ishte përfunduar procedura e përmbarimit përkatësisht pas ankantit publik. Nga ankesa e palës ankuese dhe elaborimi i saj në seancën, Komisioni nuk gjen se çka ishte e paqartë për palën ankuese. Pala ankuese vetëm përgjithsisht ngrit një pretendim lidhur me mungesën e përkthimit duke mos bërë specifikimin e ankesës. Komisioni vlerëson se një pretendim i përgjithshëm për mungesë përkthimi është i pabazuar marrë parasysh se dokumentet themelore janë të përkthyer në gjuhën turke dhe i janë vënë në dispozicion palës ankuese si dhe në ditën kritike poashtu prezent ishte edhe vjehra e palës ankuese e cila njëjtte gjuhën në të cilën zhvillohej procedura dhe gjuhën turke.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 17/2020, datë 11.12.2020

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.